



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

URDHËR

Nr. 2778, Datë 24.04.17

“PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT”

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 6, gërma ë) të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994, “Për Noterinë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ SE:

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr.8678, datë 14.05. 2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, Ministria e Drejtësisë verifikoi kushtet e ushtrimit të veprimtarisë noteriale të noterit Zj. Helga Vukaj. Fillimisht u verifikua ushtrimi i aktivitetit nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit ku nga administrimi i Ekstraktit Historik të aktivitetit për subjektin tregtar noter zj Helga Vukaj rezulton se ky subjekt nuk është regjistruar asnjëherë pranë QKB-së. Pra rezulton se ky subjekt nuk ka ushtruar aktivitet tregtar në fushën e noterisë për të cilën është pajisur me Lejen e Ushtrimit të Profesionit të Noterit, Urdhër nr. 3165, datë 22.04. 2011. Lidhur me këtë fakt u krye edhe verifikimi në Regjistrin Noterial Shqiptar (RNSH) regjistër ky i cili mbahet dhe administrohet nga Ministria e Drejtësisë, nga ku rezultoi se noteri i Dhomës së Noterisë Tiranë Zj. Helga Vukaj nuk e ushtron veprimtarinë noteriale për një periudhë kohore mbi 6 muaj, pasi në këtë sistem nuk rezultojnë të deklaruara sipas VKM-së Nr. 304, datë 21.05.2014 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të shërbimit Noterial Shqiptar, Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH)”, asnjë akt noterial. Gjithashtu pranë Regjistrin të Përgjithshëm të Noterëve, në Ministrinë e Drejtësisë, nuk rezulton se nga notere Helga Vukaj të jetë administruar e shënuar njoftim me shkrim mbi arsyet e mos ushtrimit të veprimtarisë noteriale për një periudhë kohe mbi 30 ditë rresht, ndërkohë që edhe afati maksimal 6-mujor është tejkaluar disa herë në kohë.

Referuar fakteve të mësipërme, rezulton e provuar se kemi shkelje të dispozitave të ligjit nr.7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Në ligjin nr.7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, përcaktohet se;

“Heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit bëhet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë kur:

ç) bëhet i paaftë për të ushtruar veprimtarinë për shkak sëmundjeje për një kohë më të gjatë se 6 muaj gjatë një viti;

ë) nuk ushtron veprimtarinë noteriale për një periudhë kohe deri në 30 ditë rresht pa njoftuar me shkrim Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe Ministrinë e Drejtësisë;

PËR KËTO ARSYE;

Bazuar në faktet e konstatuara më sipër, dhe në zbatim të nenit 6, gërma “ç” dhe “ë”, të ligjit nr.7829, datë 1.06.1994, “Për Noterinë”, i ndryshuar ,


URDHËROJ:

1. Heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit, znj. Helga Vukaj anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, për shkak të :
 - mos ushtrimit asnjherë të veprimtarinë noteriale;
2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a) Z. Arlind Arapi, Përgjegjës Sektori, në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.
 - b) Z. Erjon Ndreca, Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.
 - c) Z. Ermal Jahaj, Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.
 - d) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.
 - e) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Tiranë.
3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë, Tiranë. Arkivi do t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 45-ditor, një notere të Dhomës së Noterisë Tiranë.
4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres Helga Vukaj nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij urdhri.

5. Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira të njoftojë menjëherë mbi urdhërin Dhomën Kombëtare të Noterëve, e cila të bëj me dije institucionet e linjës.
6. Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira të njoftojë menjëherë mbi urdhërin zj. Helga Vukaj si dhe të bëj me dije institucionet e linjës.
7. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohet menjëherë në regjistrin e noterëve në Ministrinë e Drejtësisë.
8. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI



Miratoi: Juliana Hoxha Sekretare e Përgjithshme
Bledar Kabashi, Drejtor Inspektimi
Punoi: Arlind Arapi Përgjegjës Sektori
Kopje: 2: dt. 23.3.2017